

Fillimi > -Kronikë

VIDEO/ Shiste kokainë në Korçë, arrestohet 53-vjeçari, i gjenden dhe armë në banesë

08 Shkurt, 2021 09:30 | 1 477 shfletime



Madhësia e tekstit:  

-  **KORÇA**
-  Një 53-vjeçar është arrestuar në Korçë pasi shpërndante kokainë në qytet.
- 
-  Policia i ka gjetur në banesë shtetasit A.H, kokainë, peshore elektronike, një armë pistoletë sportive, dy armë të ftohta dhe dy suporterë kartash Sim.
- 
-  Tashmë materialet për A.H, janë në Prokurori dhe ai akuzohet për 3 vepra penale.
- 

NJOFTIMI NGA POLICIA

Korçë

Goditet një tjetër rast i shpërndarjes së drogave të forta në doza të vogla dhe i armëmbajtjes pa leje.

Posedonte lëndë narkotike, armë sportive dhe armë të ftohta në banesë, vihet në pranga 53-vjeçari me precedent të mëparshëm penal në fushën e krimeve kundër personit.

Sekuestrohen lëndë e dyshuar narkotike kokainë gati për shitje, një armë sportive, dy armë të ftohta dhe një peshore elektronike.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Korçë, në bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Narkotikëve në DVP Korçë, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, kontrolleve të shtuara për rritjen e parametrave të sigurisë, në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë policore se një shtetas posedonte armë dhe lëndë narkotike, kanë organizuar shërbimet dhe kanë ushtruar kontroll në banesën e të dyshuarit, në lagjen nr. 4, Korçë.

Forcat e Policisë, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit A. H., kanë gjetur disa doza me lëndë të dyshuar narkotike kokainë gati për shitje, letër alumini e bërë gati për përgatitjen e dozave, një sasi përzierësi, një peshore elektronike, një armë pistoletë sportive, dy armë të ftohta dhe dy suporterë kartash Sim, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit A. H., 53 vjeç (me precedent të mëparshëm penal në fushën e krimeve kundër personit).

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Mbajtja pa leje e armëve sportive”, “Mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [arme](#) [kokaine](#) [korce](#)

TË NGJASHME

FOTO EKSKLUZIVE/ Momenti kur i shumëkërkuari për vrasje Orges Bilbili i drejton armën efektivit të policisë

Klodiana Lala | 03 Shkurt, 2021

Garkullonte me armë zjarri pa leje, arrestohet i riu në Tiranë, gjatë kontrollit i zbulohet dhe...

30 Janar, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Djalin emigrant në Angli, grabitësit i shkojnë në shtëpi për herë të dytë, si i pikasi nga kamerat e sigurisë dhe u përball me autorët e armatosur 65-vjeçari

10 Shkurt, 2021

Aksident në autostradë, makina humb kontrollin dhe plagos dy këmbësorët, përfundojnë në spital

10 Shkurt, 2021

Akuzohet se vrau prostitutën shqiptare, 43-vjeçari jep dëshminë e papritur në polici

10 Shkurt, 2021

Tentohet të grabitet banesa në Fier, pronari i pikas, autorët qëllojnë me armë dhe i plagosin kushëririn

10 Shkurt, 2021

Aksident në hyrje të Sarandës, makina përplas një kalimtare, shoqërohet shoferi (Video)

10 Shkurt, 2021

Kapen 7 shqiptarë klandestinë në një anije mallrash në Britaninë e Madhe

10 Shkurt, 2021

KATEGORIA VIDEO



Zv/ministri i Shëndetësisë: Efektet e vaksinës do të ndihen në mars. 20 mijë doza pritet të vijnë tani në shkurt

10 Shkurt, 2021



Zv. ministri i Shëndetësisë debat me gazetarin/ Nikolla: Ke qasje negative ndaj qeverisë. Shkëndaj: I gatshëm të vërtetoj gjithçka them

10 Shkurt, 2021

Debati për koronavirusin/ Gazetari: Nuk ka oksigjen në Tiranë. Zv/ministri i Shëndetësisë: Nuk është e vërtetë që njerëzit e sëmurë nuk shkojnë në spital, por...

10 Shkurt, 2021

“Është gatuar një çorbë”/ Erjon Skëndaj: Ka dhe 21-vjeçarë në terapi intensive, kjo shqetëson Komitetin Teknik

10 Shkurt, 2021

Rita Ora sjell pamje të tjera nga xhirimet e klipit të ri, kësaj radhe shfaq këpucët me flamurin kombëtar

10 Shkurt, 2021

“Situata është dramatike”, zv. ministri i Shëndetësisë: Sistemi ynë shëndetësor mund të përballojë gjendjen, mbetemi vendi me më pak vdekje nga Covid në Europë

10 Shkurt, 2021